



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 9.11.2021

Lënda: Bisedime përfundimtare të Komisionerit Publik në seancën gjyqësore të datës 9.11.2021, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në çështjen ankim kundër vendimit nr. 273, datë 10.7.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Alkelina Gazidedja

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, në referencë të nenit 302 dhe 303 të Kodit të Procedurës Civile, duke u qëndruar të gjitha shkaqeve të ankimit, si dhe parashtrimeve me shkrim të paraqitura në seancat gjyqësore të datave 28.10.2021 dhe 1.11.2021, të zhvilluara në kuadër të këtij gjykimi, Komisioneri Publik konstaton se pretendimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit nuk arritën të provojnë të kundërtën e shkaqeve të ankimit.

Për sa u takon shkaqeve të ankimit, referuar edhe parashtrimeve me shkrim gjatë këtij gjykimi, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe profesionalizmit, edhe pas shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështjeje nga ana juaj, mbetet gjendja e fakteve dhe e rrethanave si vijon:

I. Për shkakun ankimor për vlerësimin e kriterit të pasurisë

1. Deklarim i pasaktë dhe i pamjaftueshëm i subjektit të rivlerësimit lidhur me pasurinë “Godinë banimi 3 kate dhe truall”, në Tiranë

1.1 Lidhur me këtë shkak ankimor, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit, në seancën e datës 28.10.2021, nuk paraqiti prova të reja mbi vlerën e shpenzimeve për investimin në këtë pasuri apo gjurmë të tjera dokumentare, që do të provonin pagesat e kryera dhe vlerën e pretenduar, duke mbajtur në konsideratë faktin që një pjesë e konsiderueshme e investimit në këtë ndërtim është kryer gjatë periudhës që subjekti ka qenë subjekt i deklaramit dhe i kontrollit të pasurive pranë ILDKPKI-së. Gjithashtu, Komisioneri Publik vlerëson se detyrimet e subjekteve të rivlerësimit, për të deklaruar investimet në ndërtimet e kryera, bazohen në përgjegjësinë e tyre për

të shpjeguar bindshëm burimet e ligjshme të krijimit të pasurive apo vlerën e saktë të investimeve të kryera, qoftë edhe në kushtet e bashkëinvestimit, referuar dhe jurisprudencës së Kolegjit¹.

1.2 Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, mbi bashkëpronësinë² e “Godinës tre kate dhe truall,” si dhe investimin e kryer për të, Komisioneri Publik vlerëson se deklaratimet e subjektit mbi pjesët takuese dhe burimet financiare të investimit për këtë pasuri, në deklaratat periodike vjetore dhe atë “Vetting”, janë kontradiktore³. Përkundër pretendimeve të subjektit, Komisioneri Publik, siç ka detajuar edhe në ankim, ka përfshirë në analizën e burimeve financiare të gjitha burimet e identifikuara gjatë hetimit administrativ nga ana e subjektit, të cilat plotësojnë kriterin e nenit D, pika 3, të aneksit të Kushtetutës.

1.3 Për sa u përket pretendimeve të subjektit mbi: (i) të ardhurat e bashkëshortit nga puna me kohë të pjesshme, në periudhën 1995 – 2005 dhe (ii) të ardhurat nga qiradhënia e banesës, Komisioneri Publik i qëndron arsytimit të detajuar në ankim. Pretendimi i subjektit se nuk i është dhënë mundësia për pagimin e këtyre detyrimeve, pasi detyrimi për deklarimin e të ardhurave ka filluar të zbatohet në vitin 2012⁴, bie ndesh me faktin se detyrimet tatimore për këto të ardhura, rezultojnë të paguara nga subjekti vetëm në vitin 2019, në përfundim të hetimit administrativ nga ana e Komisionit, pagesa që duket se janë kryer në funksion të konsiderimit të këtyre të ardhurave si të ardhura të ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3, të aneksit të Kushtetutës, për qëllim të procesit të rivlerësimit. Ky qëndrim i Komisionerit Publik bazohet edhe në referencë edhe të qëndrimeve të mbajtura nga Kolegji, në lidhje me pagesat e detyrimeve tatimore gjatë procesit të rivlerësimit në vendimet e mëparshme⁵.

1.4 Për sa u përket pretendimeve të subjektit mbi shpenzimet e jetesës për subjektin dhe familjarët e saj, Komisioneri Publik, në vlerësimin e mundësive financiare, është bazuar në standardin e përdorur nga institucionet e rivlerësimit, bazuar në korrespondencën e ILDKPKI-së me Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, me shkresën nr. *** prot., datë **.1.2019.

1.5 Në përfundim për këtë pasuri, Komisioneri Publik, sikundër ka trajtuar gjerësisht dhe në shkaqet e ankimit dhe parashtrimet në seancën e datës 28.10.2021, mbështetur dhe në Rekomandimin e ONM-së, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion, shpenzimet e pretenduara për ndërtimin e kësaj pasurie. Në mungesë të këtyre provave, duke vlerësuar si kosto ndërtimi kostot e përcaktuara në udhëzimet e Entit Kombëtar të Banesave, në fuqi në kohën e ndërtimit, për sipërfaqet e ndërtuara të pasqyruara në aktet e institucioneve zyrtare⁶, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk provoi mbulimin me burime të ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, të investimeve dhe shpenzimeve për vitet 1997-2003,

¹ (JR) 8/2019 prg. 55; (JR) 4/2020 prg. 47.

² Paragrafi 88 e në vijim të parashtrimeve të subjektit, të paraqitura në datën 28.10.2021.

³ Në D-Vett., subjekti deklaroi pasuri në bashkëpronësi, burim krijimi: puna e deklarueses, bashkëshortit në shtet dhe privat, shitja e banesës në Peshkopi, të ardhurat e vjehrrës dhe të vjehrrit, kredi bankare dhe shitje automjeti; në DV-2003 deklaroi: pjesë takuese 50% dhe burim krijimi nga shitja e banesës së familjes së bashkëshortit, në qytetin e Peshkopisë; në DV-2004 deklaroi pjesë takuese 1/3 dhe burim kredi + të ardhura; në DV-2006, pjesë takuese 50% dhe nuk deklaroi burim; në 2010 deklaroi: pjesët nuk janë caktuar... (nuk lexohet qartë) nuk deklaroi burim.

⁴ Referohuni prg. 69 – 87, të parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit, të datës 28.10.2021 etj.

⁵ Referohuni vendimeve të Kolegjit (JR) nr. 8/2019 (prg. 63 i vendimit) dhe (JR) nr. 5/2020 (prg. 41.9); (JR) 15/2021 prg. 23.

⁶ Referohuni shkresës së ASHK-së nr. *** prot., datë **.7.2019, bashkëlidhur së cilës, ndër të tjera, janë administruar: (i) planimetri i katit përdhe sip. ndërtimi 143 m², sip. verande 20,6 m², sip. banimi 163,6 m²; (ii) planimetri e katit të parë sip. ndërtimi 180,5 m², sip. banimi 180,5 m²; (iii) planimetri e katit të dytë sip. ndërtimi 192,3 m², sip. banimi 192,3 m².

2004 dhe 2006⁷, duke u gjendur kështu në kushtet e deklaramit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm në kuptim të nenit 33, pika 5, germa b), duke çuar në zbatim të nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016.

2. Për sa u përket shkaqeve të ankimit mbi pamjaftueshmërinë financiare të konstatuar, për blerjet, investimet dhe kursimet për periudhën deri në vitin 2016

2.1 *Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit në prapësimet e paraqitura në seancën e datës 28.10.2021, mbi mosdeklarimin e kursimeve cash për periudhën 2003–2015, që kanë shërbyer kryesisht si burim për pasuritë e mëposhtme:*

- Truall me sipërfaqe 437,6 m², parcela ndërtimore e Godinës së banimit me 3 kate;
- Njësi me sip. 25,7 m², me adresë rruga “**** ****”, Tiranë;
- Autoveturë *Mercedes Benc ML*, me targë ***;
- Automjet tip *Peugeot*, me targë ***, në emër të personit të lidhur ***.***.;
- Kursime në *cash* në shumën 1.400.000 lekë, deklaruar në DV 2016.

2.1.1 Komisioneri Publik vlerëson se, ashtu sikurse Kolegji ka trajtuar gjerësisht në jurisprudencën e deritanishme⁸, lidhur me detyrimin e subjekteve të rivlerësimit për të deklaruar saktësisht dhe qartësisht kursimet në *cash* në deklaratat periodike vjetore, nisur nga natyra e kësaj pasurie, deklaramet periodike vjetore përbëjnë dokument zyrtar sipas ligjit, janë të vetmet referenca të ekzistencës së likuiditeteve *cash* jashtë sistemit bankar dhe kanë vlerë prove në procesin e rivlerësimit, në zbatim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

2.1.2 Ashtu sikurse subjekti i rivlerësimit ka trajtuar në parashtrimet e datës 28.10.2021, në deklaratat periodike vjetore 2003-2015, nuk ka deklaruar në asnjë prej tyre, posedim të kursimeve në *cash* në banesë apo përdorimin e tyre si burim për krijimin e pasurive, në zbatim të detyrimeve ligjore të ligjit nr. 9049/2003, të ndryshuar.

2.1.3 Komisioneri Publik vlerëson se pretendimet e subjektit, si gjatë hetimit administrativ edhe gjatë hetimit në Kolegji, mbetën në nivel deklarativ, të paprovuara, dhe subjekti i rivlerësimit nuk provoi këtë burim të pretenduar për pasuritë si më sipër listuar, duke u gjendur kështu në kushtet e deklaramit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit 33, pika 5, gema b), duke çuar në zbatim të nenit 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016.

2.2 *Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit në prapësimet e paraqitura në seancën e datës 28.10.2021, mbi përfshirjen e të ardhurave nga qiratë⁹, si burim të ardhurash për krijimin e pasurive të mëposhtme:*

⁷ Në këtë vlerësim janë konsideruar: (i) kostoja e investimit sipas EKB-së për çdo vit, duke zbritur nga ato TVSH + fond rezervë + fitim; (ii) periudha e ndërtimit 1997 - 2003 (nisur nga fakti se, për periudhën 1997-2003, nuk provohet me dokumentacion ndarja e shpenzimeve ndër vite), viti 2004 dhe viti 2006 (sipas deklarimeve në DV vjetore); (iii) shpenzimet për familjen e subjektit për 6 persona si dhe (iv) të ardhurat vetëm ato, të cilat plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, nga ku ka rezultuar diferencë negative minimalisht në shumën -138.467 lekë, për periudhën para vitit 2003 (duke marrë në konsideratë koston e ndërtimit të llogaritur nga Komisioni, bazuar në çmimet e EKB-së, në vlerën rreth 1.8 milionë lekë para vitit 2003); – 2.443.656 lekë për vitin 2004 dhe – 2.566.001 lekë për vitin 2006.

⁸ (JR) nr. 11/2019, në prg. 27.12.18; (JR) nr. 19/2019, në prg. 84, 85; (JR) nr. 20/2019, në prg. 59; (JR) 7/2019, prg. 39; (JR) 27/2020, prg. 18; (JR) 13/2021;

⁹ Njësi shërbimi dhe banesë.

- Truall me sipërfaqe 437.6 m², parcela ndërtimore e Godinës së banimit me 3 kate;
- Automjet tip *Peugeot*, me targë ***, në emër të personit të lidhur ***.***.***.;
- Kursime në *cash*, në shumën 1.400.000 lekë, deklaruar në DV-2016.

2.2.1 Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, nuk paraqiti prova të reja mbi *arkëtimin* e shumave të pretenduara nga qiratë e banesës dhe njësisë së shërbimit, për periudhën 2010 – 2016.

2.2.2 Nisur nga fakti se, për të ardhurat e pretenduara nga qiraja e banesës dhe njësisë së shërbimit, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë **.12.2019, nuk konfirmon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore në kohën e realizimit të tyre, nuk ka asnjë dokument ku të provohet *arkëtimi* i shumave të pretenduara të qirasë nga subjekti i rivlerësimit apo personi i lidhur me të, si dhe, bazuar në faktin se detyrimet tatimore që iu takojnë këtyre të ardhurave, rezultojnë të paguara nga subjekti dhe personi i lidhur me të, gjatë hetimit administrativ (në vitin 2019), vlerësohet se këto të ardhura nuk mund të konsiderohen si të ardhura të ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, bazuar dhe në qëndrimet e deritanishme të Kolegjit mbi trajtimin e çështjeve të ngjashme (referohuni trajtimit në pikën 1. 3 më sipër).

2.2.3 Përveç sa më sipër, pretendimet e subjektit nuk mbështeten as nga aktet në dosje, pasi, bazuar në kontratën noteriale të qiradhënies nr. *** rep., nr.*** kol., datë **.11.2013, nënshkruar midis palëve ***.*** qiradhënës dhe ***.*** qiramarrëse, në nenin 4, pika 7, përcaktohet se “*Qiradhënësi do të shlyejë detyrimet tatimore që me ligj i takojnë atij*”, ndërkohë në DV- 2013 subjekti ka deklaruar si të ardhura shumën 40.000 lekë, që i korrespondon vlerës bruto të qirasë mujore. Të njëjtat kushte parashikohen dhe në kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.3.2014, me palë ***.*** qiradhënës dhe ***.*** person fizik qiramarrës.

2.2.4 Për sa më sipër argumentuar, në vlerësimin e Komisionerit Publik, të ardhurat nga qiraja (si për ambientin *njësi shërbimi*, ashtu dhe për ambientin *banesë*), detyrimet tatimore të të cilave rezultojnë të jenë paguar nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të hetimit administrativ (dhjetor 2019), për efekt të procesit të rivlerësimit, nuk mund të konsiderohen të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës.

3. Për sa i përket shkakut të ankimit mbi pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme të personit tjetër të lidhur, shtetases *.***, për dhënien hua të shumës 1.800.000 lekë, subjektit dhe personit të lidhur me të, deklaruar të përdorur si burim për blerjen e pasurisë “Njësi me sip. 25,7 m²”:**

3.1 Komisioneri Publik, në vlerësim të pretendimeve dhe shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, në prapësimet e datës 28.10.2021, mbi burimet e ligjshme të personit tjetër të lidhur, shtetases ***.***, në kufijtë e përcaktuar nga jurisprudenca e deritanishme e Kolegjit, në rastin e analizimit të burimeve të personave të tjerë të lidhur me subjektet e rivlerësimit, të cilët nuk janë subjekte deklarues, çmon se duket se përputhet pretendimi i subjektit mbi burimet e kësaj shtetase, konkretisht huas së marrë nga kjo e fundit nga z. ***.***, për pagesën e këstit të parë të pasurisë.

II. Për shkaku ankimor për vlerësimin e aftësive profesionale

4. Komisioneri Publik, duke u qëndruar të gjithave shkaqeve të ankimit të paraqitur dhe parashtrimeve në seancat gjyqësore të datave 28.10.2021 dhe 1.11.2021, të zhvilluara në kuadër të këtij gjykimi, në mënyrë të përmbledhur parashtron:

5. Lidhur me denoncimin anonim të datës **.1.2020¹⁰, Komisioneri Publik vlerëson se në lidhje me konfliktin e interesit në vendimet gjyqësore me palë ndërgjyqëse shoqërinë “****” sh. a., subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e shkaqeve të ankimit. Subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e parashikuara në pikën 1, të nenit 72, të Kodit të Procedurës Civile, pasi, në momentin e shqyrtimit të këtyre rasteve, subjekti ka pasur interes mbi këtë proces, sepse dispononte aksione në shoqërinë “****” sh.a., palë në këtë proces gjyqësor dhe, bazuar në nenin 73 të Kodit të Procedurës Civile, duhet të kishte hequr dorë nga gjykimi i këtyre çështjeve, veprim të cilin nuk e ka bërë.

5.1 Lidhur me vendimin nr.***, datë **.4.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit, me palë paditëse shoqëria “****” sh.p.k. dhe palë të paditur Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar, si dhe vendimin nr.***, datë **.2.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit, me palë paditëse i kundërpaditur Prefekti i Qarkut Tiranë dhe palë i paditur kundërpaditës ***.*** etj., Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e shkaqeve të ankimit, duke shfaqur mangësi të theksuar sipas kuptimit të nenit 75, pika 4¹¹, i ndërthurur me nenin 72, pika 2,¹² të ligjit nr. 96/2016, më konkretisht, lidhur me detyrimin kushtetues për gjykimin e paanshëm nga gjykatat, duke qenë anëtare e trupës gjyqësore në dy shkallë të ndryshme gjykimi dhe duke mos respektuar në këtë mënyrë parimin kushtetues të një procesi të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 41 dhe 42, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

6. Lidhur me denoncimin nr. *, datë **.4.2019, të paraqitur prej shtetasit ***.*****

Komisioneri Publik vlerëson se shkelja e konstatuar, lidhet me mangësi të theksuara nga subjekti, në drejtim të njohurive të ligjit, në kuptim të nenit 72, pika 2, të ligjit nr. 96/2016, ndaj duhet marrë parasysh në vlerësimin tërësor të subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

7. Lidhur me denoncimin nr. * prot., datë **.4.2019, të paraqitur prej shtetasit ***.*****

Komisioneri Publik vlerëson se shkelja e konstatuar lidhet me mangësi të demonstruara nga subjekti në drejtim të njohurive të ligjit, në kuptim të nenit 72, pika 2, të ligjit nr. 96/2016, ndaj duhet marrë parasysh në vlerësimin tërësor të subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

8. Në përfundim, Komisioneri Publik konstaton se mangësitë dhe problematikat e konstatuara në mënyrë të përsëritur edhe nga Komisioni, në rastet e mësipërme, bazuar në një vlerësim objektiv

¹⁰ I protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë **.1.2020.

¹¹ Paanësia e magjistratit në lidhje me kujdesin e tij ndaj konfliktit të interesit ... matet duke u bazuar në tregues të tillë si ... numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e magjistratit.

¹² Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e gjyqtarit për të marrë vendime gjyqësore, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin...

mbi kriteret e përcaktuara nga ligji nr. 96/2016, si dhe në një vlerësim tërësor bazuar në nenin 4, pika 2, duhet të çojnë në zbatimin e nenit 61, pika 4 apo 5, të ligjit nr. 84/2016.

9. Lidhur me të dhënat nga raporti i vlerësimit profesional

9.1 Në referencë të shkaqeve të ankimit, prapësimeve dhe akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë këtij gjykimi, Komisioneri Publik çmon se elementet e konstatuara në raportin profesional të hartuar nga KLGJ-ja, si dhe gjetjet e inspektimit të Ministrisë së Drejtësisë, të konfirmuara këto edhe nga hetimi administrativ i Komisionit, janë elemente që duhen konsideruar nga Kolegji në rivlerësimin e subjektit, znj. Alkelina Gazidedja, bazuar në vlerësimin tërësor të procedurave, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

10. Duke përfunduar për kriterin e aftësive profesionale, Komisioneri Publik, në zbatim të nenit 61, pika 4, si dhe nenit 4, pika 2, dhe nenit 61, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, konstaton se mangësitë e vërejtura janë të tilla, që nuk justifikojnë apo krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit duhet të konfirmohet në detyrë.

III. Kërkimi përfundimtar i ankimit

11. Duke përfunduar për sa parashtruar, bazuar edhe në Rekomandimin e ONM-së, Komisioneri Publik, bazuar në dispozitën e pikës 3 dhe 7, të nenit F, të aneksit të Kushtetutës, shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, kërkon nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 273, datë 10.7.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Alkelina Gazidedja.

KOMISIONERI PUBLIK

Darjel SINA